

KLSH merr pjesë në “Trajnimin e Avancuar mbi Auditimin e Performancës”

Në datat 17-19 shtator 2024 u organizua nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO) në Ankara të Turqisë “Trajnimi i Avancuar mbi Auditimin e Performancës” për Anëtarët e Grupit të Përbashkët të Punës të Aktiviteteve të Auditimit (JWGAA - Joint Working Group on Audit Activities). JWGAA është themeluar në 2002 me qëllim që të kontribuojë dhe të asistojë bashkëpunimin midis SAI-ve. Në cilësinë e bashkë kryesimit të JWGAA, SNAO garanton mbështetje për aktivitetet e SAI-ve në rajonin e Ballkanit.



Përgjatë periudhës 2020-2024 nën kujdesin e JWGAA, SNAO ka organizuar dy raunde të programit të trajnimit të auditimit të performancës auditues pa eksperiencë, të cilat rezultuan në 37 auditues performance të trajnuar dhe certifikuar. Krahas këtyre trajnimeve bazike, rrjeti i SAI-ve ka parashtruar nevojën për trajnime të avancuara mbi auditimet e performancës për auditues me më shumë eksperiencë dhe funksione metodologjike. Trajnimi i avancuar i auditimeve të performancës është përfshirë në planin e punës të JWGAA për vitin 2024 dhe 2025. Standardet ndërkombëtare të auditimit të performancës theksojnë se rekomandimet e auditimit “...duhet të jenë të bazuara mirë dhe të shtojnë vlerë. Ato duhet të adresojnë shkaqet e problemeve dhe/ose dobësive...” dhe se duhet të shmangin “...truiizmat ose ndryshe të vërtetat e njohura”, siç thuhet në ISSAI 300 (40). Duke hyrë më thellë në marrëdhënien ndërmjet shkakut dhe pasojës dhe përgjigjes së pyetjeve se pse dhe si kanë ndodhur problemet, ofrohet baza për rekomandime më të mira auditimi të cilat synojnë dhe adresojnë shkaqet e problemeve, në vend që të deklarojnë vetëm ekzistencën e problemeve.



Nga KLSH morën pjesë në këtë trajnim Kryeaudituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës z. Aulent Guri, z. Klarenc Xhaferraj dhe znj. Valdete Berisha. Krahas KLSH-së, të ftuar në këtë event morën pjesë edhe përfaqësues nga SAI-t e Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Gjeorgjisë, Bosnjes dhe Hercegovinës dhe sigurisht Turqisë si vend mikpritës i këtij trajnimit. Trajnimi u moderua nga 3 auditues me shumë eksperiencë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Përgjatë tre ditëve të trajnimit u mbajtën leksione të cilat mbuluan tema të ndryshme si prezantimin dhe krahasimin e kërkimit akademik dhe auditimit, pyetjet e auditimit, kriteret e auditimit, si dhe probleme të zakonshme me raportet e auditimit. Pas çdo leksioni bëheshin diskutime duke shpërndarë eksperiencat tona nga auditimet e kryera në të kaluarën, duke kombinuar dhe shkëmbyer njohuri dhe praktika të mira midis njëri – tjetrit. Thelbi dhe fokusi kryesor i këtij trajnimit ishte analizimi më i thellë i shkaqeve dhe arsyeve që çojnë në problematika të cilat përkthehen në “gjetje” në auditime tona dhe jo thjesht konstatimi i këtyre problemeve në “gjetjet” tona. Duhet thënë që niveli i diskutimeve, shembujve, shkëmbimit të eksperiencave me kolegët e SAI-ve të tjera ishte më shumë se i kënaqshëm duke qenë se të gjithë pjesëmarrësit kishin me dhjetëra auditime mbi supet e tyre si dhe me dhjetëra vjet eksperiencë në sektorin e auditimit dhe veçanërisht në auditimet e performancës. Në përfundim të trajnimit u diskutua mundësia për vazhdimin e takimeve apo trajnimeve të tilla në të ardhmen edhe me auditues të tjerë në mënyrë që shpërndarja e njohurive dhe praktikave të mira të bëhet edhe më gjerë.